



V E N D I M
Nr.42 Date 11.04. 2008
PER
FILLIMIN E PROCEDURAVE PER NDRYSHIMIN E LICENSES SE SHOQERISE
“DARDANIA ENERGJI” SH.P.K.

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për Procedurat e Licensimit” të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21, datë 04.04.2007, dhe nenit 18 pika 1, germa f, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 44, datë 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.04.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë En-Ku Sh.p.k. për transferimin e licenses së shoqërisë Dardania Energji sh.p.k., konstatoi paraqitjen e plote të dokumentacionit sipas kërkesave të neneve 8 dhe 9 të Rregullores së Procedurave të Licensimit, dhe shprehjen juridikisht të vullnetit të shoqërisë Dardania Energji sh.p.k për kryerjen e ndryshimeve në licensën e leshuar kësaj shoqërie,

Vendosi

1. Të fillojë procedurat për ndryshimin e licenses Nr.10 seria PV03P, leshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003, shoqërisë Dardania Energji sh.p.k.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë En-Ku Sh.p.k. dhe Dardania Energji Sh.p.k. për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta